

VEM BESTÄMMER VAD? – ALBANSKA

EU

Europeiska unionen – Unioni Evropian – bashkësi e disa shteteve evropiane e themeluar për qarkullimin e lirë të mallërave dhe njerëzve; ka për qëllim ta nxis lirinë, demokracinë, barazinë dhe mirëqenien e njerëzve.

Europaparlamentet – Parlamenti Evropian – institucion ligjvënës dhe ushtrues i funksionimit të buxhetit.

EU-kommissionen – Komisioni i UE – institucion drejtues i Unionit Evropian (qeveria evropiane).

Ministerrådet – Këshilli ministror(i UE) – merr vendime për nxjerrjen e ligjeve, më së shpeshti në bashkëpunim me Parlamentin Evropian.

Ledamot – Deputet, delegat – quhet një person të cilit i besohet një detyrë që ta përfaqësojë një grup të madh njerëzish në ndonjë organ vendimmarrës.

Proposition – Projektligj – teksti i një ligji të propozuar që i dorëzohet Parlamentit për të marrë vendim.

Snus – Burnot – duhan i bluar imët që mbahet në gojë ose thithet në hundë.



Riksdagen

Riksdagen – Parlamenti i Suedisë – Kuvend vendimmarrës dhe ligjvënës ku zënë vend përfaqësuesit e popullit në nivel vendi.

Motion – Mocion – projektligj i paraqitur nga parlamenti.

Utredet – Shqyrtoj – shikoj edhe një herë, qartësoj një çështje.

Kommunen

Kommun – Komuna – njësi e kufizuar administrative me udhëheqjen e vet politike.

Demonstration – Demonstratë – grupim popullor në hapsirë publike për të shprehur mendimet Për ose Kundër një dukuri në shoqëri. E drejta e demonstrimit në Suedi është e mbrojtur me ligj.

Petition – Peticion – kërkesë me shkrim e një personi ose grupi që i drejtohet qeverisë psh. për interesa kolektive ose individuale.

BMX-bana – Shteg BMX – pistë, terren për çiklizëm ekstrem, me biçikleta BMX.



Landstinget

Landsting – Këshilli i Qarkut – organ vendimmarrës i zgjedhur politikisht dhe që përfaqëson disa komuna.

Gränsöverskridning – Transkufitar – psh krimi që i kalon kufijtë e një vendi.

Kultur – Kulturë – fjala kulturë përfshinë çdo aktivitet njerëzor. Rëndom me këtë fjalë kuptojmë krijimin e të mirave materiale dhe shpirtërore.

Kollektivtrafik – Trafiku kolektiv – nënkupton udhëtimin e njerëzve me automjete ku blihen biletat e udhëtimit si psh me autobus dhe tren.

Turism – Turizëm – aktivitet i njerëzve jasht vendbanimit të vet, vizitë vendeve tjera në kohën e lirë.